


STATUTI
I
KOMUNËS SË SUHAREKËS

Suharekë, shtator 2008



Në mbështetje të dispozitave të nenit 12.2 dhe 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/ L-040, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më 04.11.2008 miratoi

S T A T U T I N E KOMUNËS SË SUHAREKËS

KAPITULLI I Dispozitat e përgjithshme

Qëllimi

Neni 1

1.1 Statuti i Komunës është akti më i lartë juridik i Komunës që miratohet nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

1.2 Statuti rregullon kompetencat dhe pushtetin e Komunës, pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në mbledhje, aktivitetet dhe mënyrën e vendosjes në punët publike, organet e Komunës dhe Shërbimin civil, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit, administrimin financiar, konfliktin e interesave, aktin formal, dokumentet zyrtare dhe informatat.

Neni 2

Komuna është njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale, në të cilën qytetarët e saj realizojnë vetëqeverisjen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe me Statutin e Komunës.

Neni 3

3.1 Komuna e Suharekës (në tekstin e mëtejshëm “Komuna”), ka emblemën dhe flamurin e vet.

3.2 Përmbajtja dhe përdorimi i emblemës përcaktohen me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës.

3.3 Asnjë person, përveç Komunës, nuk ka të drejtë ta përdorë emblemën, flamurin ose simbolet tjera të Komunës, për qëllime komerciale, pa autorizim të shkruar nga kryetari i Komunës.

Neni 4

4.1 Komuna e ka statusin e personit juridik.

4.2 Komuna e ka të drejtën e posedimit dhe të administrimit të pronës, mundësinë për të ushtruar padi dhe për të qenë e paditur në gjykata, të drejtën për të lidhur kontrata të drejtën për të marrë punëtorë në punë si dhe kompetenca të parapara me ligj.

Neni 5

Selia e Komunës është në Suharekë, rruga “Brigada123”.

Neni 6

Territori dhe kufijtë e Komunës janë përcaktuar me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave dhe mund të ndryshohen vetëm në përputhje me atë ligj.

Neni 7

Komunën e Suharekës, si njësi territoriale, e përbëjnë: qyteti i Suharekës, lagjet urbane dhe fshatrat. Territori i Komunës përfshin Suharekën dhe këto vendbanime: Bllacë, Budakovë, Bukosh, Breshanc, Delloc, Dobërdelan, Dragaqinë, Dubravë, Duhël, Dvoran, Greikoc, Greiçec, Gelancë, Gjinoc, Javor, Kastërc, Krushicë e Epërme, Krushicë e Poshtme, Leshan, Luzhnicë, Maqitevë, Mohlan, Mushtisht, Nepërbisht, Nishor, Papaz, Peqan, Popolan, Qadrak, Reshtan, Reqan, Savrovë, Samadrexhë, Sallagrazhdë, Semetisht, Sllapuzhan, Sopijsë, Stravuçinë Studençan, Tërrnje, Vërshec, Vraniç.

Neni 8

8.1 Kuvendi i Komunës, varësisht nga dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të Statutit të Komunës, mund të delegojë aktivitete në lidhje me dispozitat e shërbimeve komunale në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

8.2 Komiteti për Politikë dhe Financa i shqyrton dhe i propozon Kuvendit të Komunës një numër të funksioneve të veçanta, të cilat duhet të ushtrohen nga përfaqësuesit e lagjeve urbane dhe fshatrave.

8.3 Gjatë secilit vit fiskal, të gjitha marrëveshjet për mbikëqyrje të përbashkët të aktiviteteve të tilla të ndërmarra, duhet të miratohen nga Kuvendi i Komunës në pajtim me Statutin.

8.4 Të gjitha këto marrëveshje bëhen me shkrim dhe nuk mund të jenë me kohëzgjatje më të madhe sesa mandati i Kuvendit të Komunës. Marrëveshjet duhet të mbulojnë, në mes tjerash, (i) fondin, (ii) të ardhurat, (iii) shërbimet dhe (iv) administratën.

8.5 Menaxhimi i përbashkët për marrëveshjet e bëra në pajtim me dispozitat e këtij neni, zbatohen, në mes tjerash, nga një këshill i përbashkët mbikëqyrës. Kuvendi i Komunës emëron anëtarët e këtyre këshillave për t'i prezantuar dhe mbrojtur interesat e Komunës.

Neni 9

9.1 Komuna ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore të protokollit “vulat e Komunës”.

a) Vula e rrumbullakët përmban tekstin:

- rrethi i pare: *Republika e Kosovës*;
- rrethi i dytë: *Komuna e Suharekës*;
- rrethi i tretë: *Drejtoria e*

Në mes të vulës është emblema.

b) Vula e protokollit të Komunës ka formën e katërkëndëshit kënddrejtë, me tekstin:

- *Republika e Kosovës*;
 - *Komuna e Suharekës*;
 - *Drejtoria e.....*
- ____. nr. _____, më _____.

9.2 Vulat e Komunës të përshkruara në pikat *a* dhe *b*, tekstin duhet ta kenë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

9.3 Mënyra e mbajtjes dhe e përdorimit të vulave të Komunës përcaktohet me vendim të posaçëm të kryetarit të Komunës.

Neni 10

Komuna ka Ditën e Çlirimit, e cila festohet më 13 qershor të çdo viti. Me rastin e Ditës së Çlirimit, Kuvendi i Komunës përkujton dëshmorët dhe viktimat e luftës, të rënë për lirinë e Kosovës, dhe manifeston synimet e tij për një qytet të hapur, duke u angazhuar për bashkëpunim të mirëfilltë me komunat brenda dhe jashtë Kosovës.

Neni 11

11.1 Kuvendi i Komunës jep shpërblime, dekorata dhe mirënjohje.

11.2 Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë, përcakton kushtet dhe mënyrën e dhënies së shpërblimeve, të dekoratave dhe të mirënjohjeve.

11.3 Dhënia e shpërblimit ose mirënjohja në të holla, apo në vlerë të të hollave, nuk duhet ta tejkalojë shumën prej 300 € përveç në rastet kur Kuvendi i Komunës merr vendim për një shumë më të lartë.

Neni 12

E drejta e deklaramit të lirë të identitetit etnik, kulturor dhe fetar u garantohet të gjitha komuniteteve brenda territorit të komunës së Suharekës.

Neni 13

13.1 Pjesëtarët e komunitetit pakicë kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre në të gjitha organet e Komunës dhe me të gjithë nëpunësit civilë të Komunës.

13.2 Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve, dhe në të gjitha tubimet publike, diskutimet mund të bëhen në të dy gjuhët: shqipe dhe serbe.

13.3 Të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga Komuna do të jenë në gjuhën e palës. Gjuhë e palës konsiderohet gjuha në të cilën pala fillimisht i është drejtuar Komunës.

13.4 Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e fshatrave, të vendbanimeve, të rrugëve dhe të vendeve tjera publike, duhet të jenë të shkruara në të dy gjuhët: shqipe dhe serbe.

13.5 Komunikimi me institucionet komunale, Institucionet e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm IRK) dhe organet dhe organizatat tjera, bëhet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

13.6 Gjuhët zyrtare në Komunën e Suharekës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe.

Përdorimi i gjuhëve në Komunë do të rregullohet Në pajtim me nenin 9 të ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, ku për këtë çështje do të nxjerrët Rregullore e veçantë për përdorimin e gjuhëve brenda territorit të Komunës.

Neni 14

Në organet dhe shërbimet publike të Komunës sigurohet përfaqësimi proporcional i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe strukturës gjinore.

KAPITULLI II

Kompetencat Komunale

Neni 15

15.1 Komuna, brenda territorit të vet, është kompetente për sa i përket interesit lokal, duke respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm në fushat që vijojnë:

- a) Zhvillimin lokal ekonomik;
- b) Planifikimin urban dhe rural;
- c) Shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- d) Zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- e) Mbrojtjen e mjedisit lokal;
- f) Ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale;
- g) Përgjigjja ndaj rasteve emergjente;
- h) Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- i) Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- j) Ofrimin e përkujdesjes primare shëndetësore;
- k) Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesja për të rrezikuarit, strehimin familjar, përkujdesen për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- l) Banimi publik;
- m) Shëndetësinë publike;
- n) Licencimin e objekteve publike dhe objekteve duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- o) Emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike;
- p) Ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike;
- q) Turizmit;
- r) Aktivitete kulturore dhe të lira etj.

15.2 Kompetencat e deleguara nga autoriteti qendror. Komuna në pajtim me ligjin është përgjegjëse edhe për kompetencat vijuese:

- a) shërbimet kadastrale;
- b) regjistrimin civil;
- c) regjistrimin e votuesve;
- d) regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
- e) distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);
- f) mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drurëve në bazë të rregullave të miratuara nga qeveria.

KAPITULLI III

Pjesëmarrja e drejtpërdrejt e qytetarëve në mbledhjet dhe në aktivitetet vendimmarrëse për çështjet me interes publik

Neni 16

Qytetarët, në pajtim me Statutin, në Komunë mund t'i propozojnë dhe t'i shqyrtojnë çështjet me interes public, përmes:

- a) mënyrave të konsultimit dhe
- b) pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre në tubime dhe dëgjime publike.

Neni 17

17.1 Me qëllim të përmbushjes së kërkesave të qytetarëve me karakter të përgjithshëm apo të veçantë për kategori të caktuara të banorëve të qytetit, të fshatrave, të vendbanimeve apo të lagjeve urbane, Komuna organizon:

- a) Fushata informative dhe publikime për promovimin e programeve dhe të aktiviteteve komunale;
- b) Kontakte me qarqe të zgjedhura për të diskutuar politikën;
- c) Anketa lidhur me implementimin e politikave;
- d) Prezantime publike të propozimeve lidhur me politika apo projektregullore, duke ftuar në pjesëmarrje me prezantime;
- e) Kontakte me grupet përkatëse të interesit;
- f) Takime publike;
- g) Seanca publike;
- h) Shqyrtime publike;
- i) Studime për vlerësimin e ndikimit;
- j) Komitete këshilldhënëse dhe
- k) Referendum.

17.2 Arsyetimi për zgjedhjen e formave, apo të pjesëmarrjes publike, do të jepet në çdo rast dhe do të lejohet një afat kohor i mjaftueshëm për paraqitjen e prezantimeve.

17.3 Rezultatet e konsultimeve apo të pjesëmarrjes, do të merren parasysh dhe do të publikohen para se të merret vendimi përfundimtar.

Neni 18

Para miratimit të rregulloreve komunale Komuna praktikon mënyrë të gjerë të konsultave paraprake publike, duke ofruar informata të nevojshme për opinion - qytetarë të interesuar përmes formave si vijon:

- a) Publicitetit të fushatës informative për ngritjen e vetëdijesimit për propozime;
- b) Kontaktit me grupet palët e interesuara.
- c) Shpalljes publike të propozimeve;
- d) Ftesave për përfaqësuesit dhe lejimin e së paku katërmbëdhjetë ditëve për t'i shprehur pikëpamjet e tyre.

Neni 19

19.1 Komuna mban, së paku dy herë në vit, takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Data dhe vendi i takimit publikohet së paku dy javë përpara.

19.2 Në tubimet publike, përfaqësuesit komunalë i informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale.

19.3 Tubimet janë të karakterit të hapur dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit.

19.4 Tubimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.

19.5 Pjesëmarrësit në këto tubime mund të marrin iniciativa, të japin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

19.6 Njëra prej këtyre tubime duhet të mbahet në gjashtëmuajorin e parë të vitit, ndërsa tjetra në gjashtëmuajorin e dytë.

19.7 Nëse gjatë vitit mbahen vetëm dy mbledhje publike, atëherë ndërmjet këtyre mbledhjeve duhet të ketë një interval kohor prej së paku tre muajsh.

19.8 Tubimet e tilla mund të organizohen edhe nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje të caktuara urbane.

Neni 20

Vendi, data dhe koha kur do të mbahen tubimet publike shpallen në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në ndërtes/ën-at e Komunës dhe në vendet më frekuentuese në qytet, fshatra, vendbanime dhe lagje urbane, si dhe në web-faqen e Komunës dhe atë 14 ditë para mbajtjes së tubimit. Shpalljen publike e bën Zyra për Marrëdhënie me Publikun.

Neni 21

21.1 Tubimet publike i udhëheq dhe i kryeson kryetari i Komunës, apo përfaqësuesi i tij.

21.2 Kryetari është i autorizuar ta caktojë rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevoje, ka të drejtë që t'i ndërpresë diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe pushtetin e Komunës. Ai mund t'i refuzojë, t'i thërrasë ose t'i dëgjojë diskutuesit, të cilët prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet dhe mund ta caktojë kohën e paraparë për diskutim.

21.3 Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë tubimit publik, për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së tubimit.

Neni 22

22.1 Për çdo tubim publik mbahet procesverbali, i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunalë, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.

22.2 Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna, në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit, e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa. Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në tubim dhe bën rekomandimet e nevojshme, të cilat i'a propozon Kuvendit të Komunës për tubimin e ardhshëm.

Neni 23

23.1 Në pajtim me dispozitat e ligjit mbi vetëqeverisjet lokale (neni 69), secili qytetar dhe person juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë që me vetiniciativë, përmes formës së peticionit, t'i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e akteve juridike, me të cilat do të zgjidhen çështje të rëndësishme për qytetin, fshatin, vendbanimin dhe lagjen urbane në pajtim me ligjin dhe Statutin e Komunës.

23.2 Subjektet e përmendur më lart mund t'i drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij në mënyrë të pakufizuar, e që kanë të bëjnë me:

- a) rregullimin e qytetit dhe të fshatrave;
- b) mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës së komunës;
- c) urbanizimin e qytetit dhe të fshatit;
- d) mirëmbajtjen e mjedisit jetësor;
- e) implementimin e vetëkontrollit dhe
- f) çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.

23.3 Një iniciativë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre në formë të peticionit, me propozim të veçantë të çështjes së caktuar, dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes Zyrës për marrëdhënie me publikun.

23.4 Kuvendi i Komunës mund të delegojë shqyrtimin e peticioneve të tilla në komitetet e përhershme.

23.5 Kur një peticion nënshkruhet nga më shumë se 2000 qytetarë të regjistruar në listën e votuesve, e që ka të bëjë me çështjet që janë të lidhura me qytetin, Kuvendi i Komunës duhet ta shqyrtojë çështjen.

23.6 Për fshatra dhe lagje, peticioni do të jetë i vlefshëm nëse atë e nënshkruajnë 51% të banorëve të regjistruar në regjistrat e votuesve.

23.7 Çdo peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtrues/it-ve, emrin dhe adresën e nënshkrues/it-ve, si dhe lëndën e peticionit. Lënda e peticionit duhet të ceket qartë në secilën faqe. Komunitetet mund t'i bëjnë peticione Kuvendit të Komunës përmes Komitetit të Komuniteteve. Përmbajtja e peticionit duhet të jetë siç është cekur më lart. Një peticion i cili nuk përmban elementet e duhura nuk do të konsiderohet i vlefshëm.

Neni 24

24.1 Zyra për marrëdhënie me publikun, përmes Kryetarit të Komunës, në afat prej 30 ditësh çdo peticion të vlefshëm ia prezanton Kuvendit të Komunës nga dita që ai e pranon. Kuvendi i Komunës mund t'i shqyrtoj vet ose t'ia referojë për shqyrtim të mëtejme komitetit të caktuar. Përfaqësuesit e parashtruesve të peticionit e kanë të drejtën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje të komitetit dhe të Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të peticionit.

24.2 Vendimin përfundimtar për çështjen e peticionit e merr Kuvendi i Komunës, në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e prezantimit të peticionit në Kuvend. Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe do t'i komunikohet parashtruesit-ve të peticionit.

Referendumi

Neni 25

25.1 Për çështjet me interes të përgjithshëm, që kanë të bëjnë me kompetencat e Komunës, për të cilat Kuvendi i Komunës, për arsye të ndryshme, nuk merr vendim përfundimtar, Komuna organizon referendum.

25.2 Qytetarët e komunës mund të kërkojnë që rregullorja e Kuvendit të komunës e miratuar nga Kuvendi i komunës, t'i nënshtrohet referendumit.

25.3 Kërkesa duhet t'i dorëzohet kryesuesit të Kuvendit të komunës, brenda 30 ditësh nga data e miratimit të rregullores e cila duhet të nënshkruhet nga 10% e votuesve të regjistruar.

25.4 Kuvendi i komunës duhet ta shqyrtojë kërkesën brenda 30 ditësh pas pranimit të peticionit në pajtim me ligjin në fuqi.

KAPITULLI IV

Organet e Komunës

Neni 26

Organet e Komunës janë: Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.

Kuvendi i Komunës

Neni 27

27.1 Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i Komunës, i cili ushtron funksionin e pushtetit lokal të përcaktuar me ligj dhe Statutin e Komunës.

27.2 Kuvendi i Komunës do të ketë numrin e anëtarëve të kuvendit sipas ligjit mbi vetëqeverisjen lokale.

27.3 Përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës duhet të ushtrohen nga Kuvendi i Komunës dhe organet e Komunës, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj dhe Statutin e Komunës.

27.4 Kuvendi zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, në pajtim me dispozitat e Ligjit për zgjedhjet në fuqi.

27.5 Anëtarët e Kuvendit kanë të drejta të njëjta dhe mundësi për të marrë pjesë në proceset e Kuvendit.

Neni 28

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

28.1 Kuvendi i komunës funksionon në bazë të ligjit, statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

28.2 Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për;

- a) Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- b) Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- c) Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;
- d) Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- e) Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij ligji;
- f) Niveli i tarifave dhe ngarkesave;
- g) Kompensimi për anëtarët e Kuvendit;
- h) Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- i) Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- j) Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- k) Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- l) Përgjegjësitë të tjera që kërkohen me ligj.

28.3 Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komitetit të Kuvendit të komunës, apo kryetarit të komunës. Kuvendi i komunës mund të tërheq delegimin në çdo kohë.

Aktet e Kuvendit të komunës

Neni 29

29.1 Kuvendi i komunës miraton akte brenda fushës së kompetencave të tij

29.2 Aktet e Kuvendit të komunës vlejn në territorin e komunës që ka miratuar aktin.

Këto akte përfshijnë:

- a) statutin e komunës;
- b) rregulloren e punës;
- c) rregulloret komunale; dhe
- d) çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim efikas të komunës.

29.3 Statuti i komunës miratohet dhe mund të ndryshohet me, së paku, votim të dy të tretës së anëtarëve të Kuvendit të komunës.

29.4 Rregullorja e punës miratohet dhe ndryshohet, kur të jetë e nevojshme, me votimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të komunës.

Aktet e Kryetarit të Komunës

Neni 30

30.1 Kryetari i komunës ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime brenda fushës së kompetencave të tij.

Mbledhja inauguruese e Kuvendit të komunës

Neni 31

31.1 Kuvendi i Komunës mban mbledhjen inauguruese, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e certifikimit të rezultateve zgjedhore. Anëtari më i moshuar i Kuvendit i kryeson mbledhjet derisa kryesuesi ta bëjë betimin.

31.2 Anëtarët e Kuvendit të Komunës e bëjnë betimin dhe atë e nënshkruajnë.

Përmbajtja e betimit është si vijon:

“Unë _____, betohem se do t’i kryej detyrat me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit, dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Suharekë, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.”

Kryesuesi i Kuvendit të komunës

Neni 32

32.1 Kuvendi i komunës e zgjedh kryesuesin e Kuvendit nga radhët e anëtarëve.

32.2 Kryesuesi i Kuvendit të komunës zgjidhet për një mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit.

32.3 Votimi në të gjitha zgjedhjet për kryesues të Kuvendit të komunës është me vota të fshehta.

32.4 Për t'u zgjedhur në votimin e parë, kandidati duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.

32.5 Në rast se në votimin e parë asnjëri prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur do të zgjidhet kryesues i Kuvendit të komunës.

Mbledhjet e Kuvendit të komunës

Neni 33

33.1 Kryesuesi i Kuvendit të komunës thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Në mungesë të kryesuesit, mbledhjen e udhëheq anëtari i Kuvendit, i autorizuar nga kryesuesi.

33.2 Kuvendi i komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e Punës.

33.3 Të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Një njoftim i till shkruhet:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes;
 - b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
 - c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
 - d) rendi i ditës për mbledhje; dhe
 - e) materialet e mbledhjes.
- f) të dhënat të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

33.4 Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin mbi gjuhët. I njëjti njoftim duhet të shpallet publikisht.

33.5 Njoftimi nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni duhet gjithashtu t'i dërgohet ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.

Takimet e jashtëzakonshme të Kuvendit të komunës

Neni 34

34.1 Takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit të komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga, më së paku, një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të komunës, apo me kërkesë të kryetarit.

34.2 E drejta për të thirrur një takim të jashtëzakonshëm gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.

34.3 Pikat e caktuara të rendit të ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.

34.4 Takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit të komunës nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim, siç kërkohet me rregulloret e punës, së paku tri (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit.

34.5 Procedurat e njëjta që kërkohen për njoftimin dhe çështjet e tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme gjithashtu.

34.6 Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

Neni 35

35.1 Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij, mbahet procesverballi. Procesverballi përfshinë emrat (evidencën) e anëtarëve të pranishëm dhe të anëtarëve të ftuar, rendin e ditës, thelbin e diskutimit, rezultatin numerik të votimit dhe propozimet e miratuara apo të refuzuara. Nëse kërkohet të thirret me emër secili anëtar, në procesverbal shënohet si ka votuar secili.

35.2 Procesverbalin e mban një shërbyes civil, i caktuar nga shefi i shërbimit të kryetarit të komunës.

35.3 Kryesuesi e nënshkruan procesverbalin e miratuar nga Kuvendi.

Konflikti i interesave të anëtarëve të Kuvendit

Neni 36

36.1 Anëtari i Kuvendit të Komunës, apo anëtari i komitetit, nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilat do çështje, në të cilën ai, apo ndonjëri anëtar i afërt i familjes së tij, ka interes personal apo material.

36.2 Secili anëtar duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në cilëndo nga mbledhjet në të cilat është i pranishëm. Secili anëtar duhet të ofrojë informacione që janë në interes të anëtarit tjetër.

36.3 Secili anëtar duhet të tërhiqet vullnetarisht nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, kur konsideron se ato mund të çojnë deri te konflikti i interesave.

36.4 Anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk mund të punësohen në asnjë pozitë udhëheqëse në Komunë, nëse më parë nuk kanë hequr dorë nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës.

36.5 Anëtarët e Kuvendit para mbledhjes së parë të Kuvendit, në një deklaratë të plotë dhe të hapur, shënojnë interesat e tyre financiare dhe atë regjistër e mban shefi i shërbimit të kryetarit. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa të ndodhë.

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit të komunës

Neni 37

37.1 Të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës kanë të drejta dhe mundësi të barabarta të marrin pjesë plotësisht në punimet e Kuvendit. Kuvendi i komunës siguron që këto të drejta dhe mundësi të parashikohen në Statutin dhe në rregulloren e tij të punës.

37.2 Anëtari i Kuvendit të komunës ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga kryetari, apo kryesuesi i Kuvendit. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e punës.

37.3 Anëtari i Kuvendit të komunës mund të dorëzojë vërejtje me shkrim, të cilat i bashkëngjiten procesverbalit.

37.4 Anëtari i Kuvendit të komunës mund t'iu drejtohet të pranishmëve në cilindo komision të Kuvendit të komunës anëtar i të cilit nuk është, por nuk mund të votojë. Ai apo ajo mund t'iu propozojë kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është përgjegjësi e komitetit.

37.5 Anëtari i Kuvendit të komunës mund të kërkojë nga kryetari informacione që janë të nevojshme për punën e tij si anëtar. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen, ai apo ajo mund ta ngritë çështjen në Kuvendin e komunës.

37.6 Anëtari i Kuvendit të Komunës lejohet të mungojë nga vendi i punës për periudhën kohore që janë të domosdoshme për kryerjen e punëve të Kuvendit.

37.7 Kuvendi i komunës, në pajtim me Statutin e komunës dhe me udhëzimet e nxjerra nga qeveria qendrore, mund t'iu ofrojë kompensim anëtarëve të Kuvendit për punën e tyre në Kuvendin e komunës.

37.8 Anëtarët e Kuvendit të komunës detyrohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të thirrura në mënyrë të duhur në komisionet ku ata janë anëtarë, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të justifikueshme për mungesën e tyre.

Mandati

Neni 38

38.1 Mandati i anëtarëve të Kuvendit të komunës është katër vite.

38.2 Anëtari i Kuvendit të komunës pushon të jetë anëtar:

- a) me rastin e përfundimit të mandatit të tij;
- b) nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur;
- c) nëse anëtari ia paraqet kryesuesit të Kuvendit dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;
- d) nëse anëtari ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe është lëshuar urdhër për burgim për gjashtë ose më shumë muaj;
- e) nëse anëtari nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e Kuvendit të Komunës pa arsye;
- f) nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm s'kualifikon apo e konsideron të pa përzgjedhshëm.

Komitetet e përhershme

Neni 39

39.1 Kuvendet komunale themelojnë Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete si komitete të përhershme.

39.2 Kuvendi i komunës themelon komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tyre.

39.3 Komitetet tjera mund të kooptojnë në radhët e tyre individ që nuk janë anëtar të Kuvendit të komunës, por shumica e anëtarëve të komiteteve duhet të jenë gjithnjë anëtar të Kuvendit të komunës.

39.4 Nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, komitetet reflektojnë përbërjen e Kuvendit të komunës.

Komiteti për Politikë dhe Financa

Neni 40

40.1 Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga kryesuesi i Kuvendit të komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e etniteteve politike në Kuvendin e komunës.

40.2 Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjëse për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditim të brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e komunës.

Komiteti i Komuniteteve

Neni 41

41.1 Komiteti për Komunitete përfshin në radhët e veta shumicën e thjesht nga anëtarët e Kuvendit të komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga së paku një përfaqësues në Komitetin për Komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të Komitetit të komuniteteve.

41.2 Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për tu avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Komitetet konsultative

Neni 42

42.1. Kuvendi i komunës themelon Komitete këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes

42.2. Anëtarësia e komiteteve përbëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e Organizatave joqeveritare.

42.3. Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime, bëjnë hulumtime dhe ofrojnë mendime për iniciativat e Kuvendit të komunës në pajtim me Statutin e komunës.

42.4 Kryesit e fshatrave-vendbanimet, do të zgjidhen në bazë të rregullores 01-Nr 214 të datës 31.08.2001 për zgjedhjen e kryesive të fshatrave.

KAPITULLI V

UDHËHEQËSIA KOMUNALE-EKZEKUTIVI

Zgjedhja e Kryetarit të Komunës

Neni 43

43.1 Kryetari i Komunës zgjidhet drejtpërdrejt nga banorët që kanë të drejtë vote në komunë, në përputhje me ligjin mbi zgjedhjet komunale që është në fuqi, për mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës.

43.2 Mandati i kryetarit të komunës përfundon:

- a) kur ta kryen mandatin e tij;
- b) nëse vdes;
- c) nëse jep dorëheqje;
- d) nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër;
- e) nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se një muaj pa arsye;
- f) nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me ligjin në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon kryetarin e komunës nga cilësia juridike; dhe
- g) në rast të dënimit për veprë penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër.

Bërja e betimit

Neni 44

Me rastin e zgjedhjes, kryetari i Komunës e bën betimin përpara anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Përmbajtja e betimit është si vijon:

“Unë _____, betohem se do t’i kryejë detyrat dhe do t’i ushtrojë kompetencat e mia si kryetar i Komunës së Suharekës, me nder, besnikëri, paanshmëri, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë.”

Përgjegjësitë e kryetarit

Neni 45

45.1 Kryetari i komunës përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;

- a) udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj;
- b) ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të komunës apo komiteteve të tij;
- c) ekzekuton aktet e Kuvendit të komunës;
- d) emëron apo shkarkon vartësit e tij;
- e) organizon punën dhe drejton politikën e komunës;
- f) propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e komunës;
- g) propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- h) raporton para Kuvendit të komunës, për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku një herë në gjashtë muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i komunës;
- i) mund të kërkojë që Kuvendi i komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti i tillë cenon legjislacionin në zbatim apo interesin e komuniteteve.

Konfliktet e interesit

Neni 46

46.1 Menjëherë pas zgjedhjes së tij, Kryetari i komunës duhet të ndërprejë çdo kontratë apo lidhje që ka, e cila mund të vë në pikëpyetje aftësinë e tij për kryerjen e paanshme dhe të drejtë të detyrave nga kompetencat e tij.

46.2 Kryetari i komunës, përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse dhe administrative që kanë të bëjnë me ndonjë çështje, në të cilën ai, apo ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal apo familjar.

46.3. Nga Kryetari i komunës, kërkohet t`i paraqes konfliktet e interesit sapo të paraqiten ato.

46.4. Kryetari i komunës mundet vullnetarisht ta përjashtoj veten nga vendimmarrja dhe procedurat administrative, nëse konsideron se mund të jetë konflikt të interesit. Kryetari i komunës shënon çdo ndryshim në gjendjen financiare menjëherë pasi ai të paraqitet.

Neni 47

47.1 Ekzekutivi i komunës-kryetari për të ushtruar përgjegjësit e përcaktuara me ligj dhe përgjegjësit e përcaktuara nga Kuvendi i komunës, ndihmohet nga nënkryetari i komunës dhe administrata komunale-drejtorët e drejtorive.

47.2 Administrata komunale organizohet në drejtori. Komuna e Suharekës mund t`i ketë deri në dhjetë (10) drejtori. Çdo drejtori komunale udhëhiqet nga drejtori.

47.3 Kryetari i komunës i propozon Kuvendit numrin e drejtorive dhe funksionimin e tyre në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

47.4 Drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga kryetari i komunës.

Nënkryetari i komunës

Neni 48

48.1. Kryetari komunës ka një nënkryetar

48.2. Nënkryetari emërohet nga Kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari

48.3. Nënkryetari i ndihmon Kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij.

48.4. Kur posti i Nënkryetarit mbetet i lirë, Kryetari emëron Nënkryetarin e ri, jo më vonë se 30 ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

48.5. Për konflikt të interesit të Nënkryetarit zbatohen të njëjtat rregulla si në nenin 46 të këtij statuti që vlen për Kryetarin

Shkarkimi i Kryetarit

Neni 49

49.1 Kryetari i komunës mund të suspendohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 64 të Ligjit mbi qeverisjen lokale

49.2 Qytetarët e komunës, mund të marrin iniciativë për largimin e Kryetarit të komunës, në pajtim me nenin 72 të Ligjit mbi qeverisjen lokale.

ADMINISTRATA KOMUNALE

Shërbimi civil komunal

Neni 50

50.1 Shërbimi civil komunal përfshin të gjithë personat e punësuar nga Autoriteti komunal, rroga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, përveç;

- a) Kryetarit, nënkryetarit dhe drejtorëve komunalë;
- b) Kryesuesit dhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit të komunës.

50.2 Drejtorët komunal, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve, nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civil të administratës së komunës, nuk mund të jenë anëtar të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo Kuvendit të komunës ku ata punojnë.

50.3 Zgjedhjet për Kuvendin e komunës, nuk përbëjnë shkak për rishqyrtimin e emërimeve të shërbyesve civil.

Neni 51

Administrata komunale dhe udhëheqësi i personelit

51.1 Administrata komunale organizohet në drejtori.

51.2 Administrata komunale ka udhëheqësin e personelit.

51.3 Kryetari shpall, rekruton dhe largon udhëheqësin e personelit në pajtim me ligjin e aplikueshëm për shërbim civil.

51.4 Nëse posti i personelit mbetet i zbrazët kryetari i Komunës emëron një anëtar të lart të shërbimit civil komunal në cilësinë e kryesuesit të detyrës së udhëheqësit të personelit.

51.5 Brenda 60 ditësh, kryetari rekruton udhëheqësin e personelit në pajtim me pikën 51.2 të këtij neni.

Neni 52

Nëpunësi i administratës komunale përjashtohet nga vendimmarrja dhe procedura administrative lidhur me ndonjë çështje me të cilën ai apo ajo, ose ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij ka interes personal ose financiar.

Avokati publik

Neni 53

Avokati publik funksionin e vet e ushtron konform ligjeve në fuqi dhe bën padi në emër dhe llogari të Komunës, i përfaqëson organet e Komunës pranë organeve të judikaturës në Kosovë.

Avokati publik ushtron kallëzime penale ndaj personave që dëmtojnë interesin e përgjithshëm shoqëror të Komunës.

Avokati publik emërohet sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe për punën e vet i raporton kryetarit të komunës.

KAPITULLI VI

Administrimi financiar

Buxheti i Komunës

Neni 54

54.1 Për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet e parapara me Ligj dhe Statut, Komuna duhet të ketë buxhetin e saj (buxheti i Komunës).

54.2 Buxheti i Komunës duhet të jetë i balancuar, i përgatitur në mënyrë transparente dhe i bazuar në shkresat (qarkoret buxhetore, udhëzime etj), të lëshuara nga MEF-i.

54.3 Buxheti i Komunës duhet të përmbajë planin për aktivitetet dhe udhëheqje ekonomike brenda vitit fiskal, dhe duhet të përfshijë të gjitha parashikimet e të hyrave, shpenzimet kapitale dhe ato të përditshme të Komunës. Ai gjithashtu duhet t'i ndajë fondet ekzistuese për nevojat e shpenzimeve të Komunës.

Të hyrat nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave (Grantet Qeveritare)

Neni 55

55.1 Qeveria përmes Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, bën transferime financiare për komunat, duke u bazuar në kriteret objektive, përfshirë edhe vlerësimin e nevojave dhe burimeve financiare për Komunë.

55.2 Një pjesë e këtyre fondeve të transferuara, mund të ndahet për veprimtari të caktuara specifike.

55.3 Komuna duhet të njoftohet me kohë për shumën e fondit të transferuar për vitin e ri fiskal, në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj.

Të hyrat vetanake të Komunës

Neni 56

Komuna në pajtim me ligjet, rregulloret, urdhëresat, udhëzimet dhe instrukcionet krijon të hyra vetanake nga:

- a) licencat, taksat, tarifatat dhe ngarkesat;
- b) tatimi në pronë;
- c) të ardhurat dhe pasuria e Komunës;
- d) gjobat dhe dënimet; dhe
- e) të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës komunale.

Të hyrat nga donatorët

Neni 57

57.1 Për ta ndihmuar zhvillimin e komunës donatorët mund të derdhin mjetet në buxhetin e Komunës.

57.2 Nëse donatorët derdhin mjete në buxhetin e Komunës me destinim të caktuar, ato mjete nuk mund të përdoren për qëllime të tjera.

57.3 Donatorët kanë të drejtë të informohen për mënyrën e harxhimit të mjeteve që i kanë derdhur në buxhetin e Komunës.

Të hyrat nga vetëkontributi

Neni 58

Për t'i përmbushur më mirë, apo për t'i përmirësuar nevojat e banorëve të saj, Komuna mund të sigurojë mjete edhe përmes deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve në pajtim me ligjet në fuqi. Mjetet e siguruara në këtë mënyrë mund të shfrytëzohen vetëm për atë qëllim që janë deklaruar qytetarët. Mënyra e deklarimit dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë

me vetëkontributin, më hollësisht definoohen me ligj dhe me vendim për dhënien e vetëkontributit.

Neni 59

59.1 Komuna disponon në mënyrë të pavarur të hyrat që i takojnë.

59.2 Për mënyrën e përdorimit të mjeteve, Kuvendi i Komunës duhet të vendos në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 60

Buxheti i ndërmarrjeve komunale

60.1 Komuna miraton buxhetin e ndërmarrjeve komunale që kryejnë shërbime komunale. Buxheti i propozuar nga ndërmarrjet komunale, duhet të përfshijë lartësinë e tarifës së propozuar për shërbimet që i kryen ndërmarrja dhe të dhënat tjera të parapara me ligj.

60.2 Propozimi i buxhetit duhet t'i dorëzohet Kuvendit për miratim më së largu deri më 1 dhjetor para vitit të ardhshëm fiskal.

60.3 Komuna e kontrollon dhe e mbikëqyrë afarizmin financiar të ndërmarrjeve publike komunale dhe të të gjitha organizatave jofitimprurëse të cilat marrin ndihmë financiare nga Komuna.

60.4 Ndërmarrjet komunale janë të obliguara që raportin financiar vjetor ta dorëzojnë deri më 31 mars të vitit vijues.

KAPITULLI VII

Auditori i brendshëm

Neni 61

61.1 Auditori ka të drejtë t'i shikojë të gjitha deklaratat financiare, librat, shkresat dhe dokumentet tjera, dhe mund të kërkojë ndonjë informatë e cila atij i duhet për kryerjen e kontrollit.

61.2 Auditori i auditon të gjitha deklaratat financiare të ndërmarrjeve komunale.

61.3 Auditori i auditon të gjitha raportet financiare të të gjitha organizatave të cilat marrin ndihmë financiare nga Komuna.

61.4 Gjithkush, mund t'i paraqesë ankesë auditorit lidhur me deklaratat financiare dhe çështjet tjera financiare të Komunës dhe auditori mund të bëjë hetime lidhur me to.

61.5 Auditori i brendshëm, duhet të përgadis dhe dorëzoj, Komisionit të Auditimit për shqyrtim dhe miratim, një plan strategjik tre vjeçar në bazë të vlerësimit të rreziqeve. Auditori i brendshëm i raporton Komisionit të Auditimit për të gjitha auditimet siq është paraparë në nenin 5 të Ligjit për Auditimin e Brendshëm.

61.6 Çdo raport i auditimit bëhet publik në pajtim me Ligjin për auditimin e brendshëm .

KAPITULLI VIII

Dispozitat përfundimtare

Neni 62

Harmonizimi i të gjitha rregulloreve të Komunës dhe akteve tjera komunale, duhet të bëhet në afat prej 6 muajsh nga dita e miratimit të këtij Statuti.

62.1 Të gjitha dispozitat Statutit duhet të jenë në harmoni me dispozitat e Ligjit. Në rastet kur egziston ndonjë konflikt midis dispozitave të këtij Statuti dhe dispozitave të Ligjit, atëherë vlejné dispozitat e Ligjit.

Neni 63

63.1 Pas miratimit në Kuvendin komunal, ky Statut hyn në fuqi, 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale.

63.2 Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Statuti, pushojné të vlejné dispozitat e Statutit të Kuvendit të Komunës së Suharekës **01 nr 235 të datës 06.06.2008.**

KUVENDI I KOMUNËS SË SUHAREKËS

01-Nr-8336

Datë 11.11.2008

KRYESUESI I KUVENDIT



Rexhep Kuçi

